




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi



RAPORT PERIODIK

2026

JANAR - QERSHOR

I NjAB-së PËR AUDITIMIET E PËRFUNDUARA DHE
AKTIVITETET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Korrik, 2026

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Llogaridhënia menaxheriale.....	4
3. Planifikimi i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm	4
4. Rezultatet kryesore për periudhën janar-qershor 2026	4
5. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve	5
6. Bashkërendimi me Komitetin e Auditimit.....	5
7. Bashkërendimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) – Auditorin e Jashtëm.....	5
8. Detyrat e Shërbimit Këshillues dhe aktivitetet tjera të NJAB-së.....	6

1. ADRESIMI I UDHËHEQËSIT TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Gjashtëmujor të Punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në Komunën e Prizrenit për periudhën 1 janar – 30 qershor 2026.

Ky raport është përgatitur në përputhje me nenin 25, paragrafi 3.5 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe në pajtim me metodologjinë e auditimit të miratuara nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm (NjQHAB) në MFPT dhe Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm.

Raporti paraqet një pasqyrë të detyrave audituese dhe aktiviteteve të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, duke përfshirë auditimet e kryera, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, aktivitetet këshilluese, bashkëpunimin me Komitetin e Auditimit dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, si dhe aktivitetet e tjera të ndërmarra në kuadër të mandatit të NjAB-së.

Përmes auditimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe, NjAB ka ofruar siguri të pavarur dhe objektive lidhur me efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e qeverisjes në Komunën e Prizrenit. Rekomandimet e dhëna kanë për synim përmirësimin e proceseve të punës, forcimin e kontroleve të brendshme, rritjen e pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe përdorimin më efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve publike.

Raporti është hartuar në bazë të Planit Vjetor të Punës së NjAB për vitin 2026 dhe pasqyron shkallën e realizimit të aktiviteteve të planifikuara gjatë periudhës raportuese. Njëkohësisht, ai ofron informacion për progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe identifikon fushat ku nevojiten përmirësime të mëtejshme nga menaxhmenti komunal.

2. Hyrje

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në strukturën organizative të Komunës funksionon brenda Zyrës së Kryetarit të Komunës. NjAB aktualisht përbëhet nga Udhëheqësi i Auditimit dhe një auditor. Njësia ka pavarësi funksionale në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e auditimeve. Ky funksion operon në harmoni me Rregulloren (QRK) Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Auditimit të Brendshëm në subjektet e sektorit publik.

Ky raport është përgatitur në përputhje me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Auditimit të Brendshëm në subjektet e sektorit publik dhe paraqet aktivitetet, rezultatet dhe arritjet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) për periudhën 1 janar – 30 qershor 2026.

3. Llogaridhënia dhe raportimi

Llogaridhënia

- Auditimi i Brendshëm i përgjigjet drejtpërdrejt udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe vepron në përputhje me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Rregulloren për Auditimin e Brendshëm, Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm dhe Kodin e Etikës;
- Kryen funksionin e auditimit në mënyrë të pavarur, objektive dhe në përputhje me legjislacionin dhe standardet profesionale.
- Është përgjegjës për planifikimin dhe realizimin e auditimeve sipas planeve të miratuara.

Raportimi

- Auditimi i Brendshëm përgatit dhe dorëzon raportet e auditimit me të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet, te Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i njësisë së audituar;
- Raporton periodikisht dhe përmes raportit vjetor mbi aktivitetet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, te Kryetari i komunës, Komiteti i Auditimit dhe Njesia për Harmonizim e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave;
- Informon udhëheqësin e subjektit për statusin e zbatimit të rekomandimeve.

4. Planifikimi i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm

- Në përputhje me nenin 25 të Ligjit Nr. 06/L-021, Plani Strategjik dhe Plan Vjetor i Auditimit për vitin 2026 janë përgatitur dhe miratuar në muajin dhjetor 2025. Plan i është bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe ka përfshirë gjithsej gjashtë (6) detyra audituese. Përveç auditimeve, plani ka përfshirë edhe aktivitetet tjera audituese dhe administrative, raportimet periodike, koordinimin institucional me ZKA, NjQHAB/MF, shërbimet këshilluese, trajnimet profesionale etj.
- Procesi i auditimit zhvillohet në katër(4) faza: planifikimi, puna në terren(testimi dhe verifikimi), raportim dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve.
- Njesia e audituar ka për detyrë të hartojë Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Objektiva e Auditimit të Brendshëm për vitin 2026

1. Rishikimi periodik dhe vjetor i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e Auditorit të Brendshëm;
2. Detyrat audituese (auditimet) duke u bazuar në planin e punës për vitin 2026, janë paraparë: gjashtë (6) detyra audituese (auditime) me qëllim të përcaktimit nëse veprimet dhe rezultatet e proceseve të audituara, janë në pajtim me ligjet, udhëzimet dhe rregulloret përkatëse;
3. Raportimi periodik për: Kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe Njesisë Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave, Punes dhe Transfereve;
4. Raportet periodike të rishikimit të rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombetare e Auditimit;
5. Bashkërendimi i aktiviteteve me ekipin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), bashkërendimi i aktiviteteve me NjQHAB/MF;
6. Mbajtja e takimeve me Komitetin e auditimit(janë parapa mbajtja e së paku 4 takimeve brenda vitit);
7. Detyrat e këshillëdhënies për menaxhmentin e Komunës.

5. Rezultatet kryesore për periudhën janar-qershor 2026

Gjatë periudhës raportuese janë përfunduar:

- 3 raporte të auditimit;
- 2 raporte për rishikimin e zbatimit të rekomandimeve.

Detyrat audituese të përfunduara:

1. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve: **Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë auditimeve të brendëshme për vitin 2025.** Është dhënë 1 rekomandim;
2. Auditimi i Performancës: **Subvencionimi me mekanizëm bujqësor (2024–2025).** Janë dhënë 3 rekomandime.
3. Auditimi i Pajtueshmërisë dhe Financiar: **Obligimet e papaguara për vitin 2025 dhe periudhën janar–mars 2026.** Janë dhënë 2 rekomandime.
4. Auditimi i Pajtueshmërisë dhe Financiar: **Procesi i planifikimit dhe arkëtimit të të hyrave nga tatimi në prone.** Janë dhënë 3 rekomandime.
5. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve: **Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë auditimeve të brendëshme për gjashtë mujorin e parë të vitit 2026** Është dhënë 1 rekomandim.

6. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve

Gjatë periudhës raportuese janë rishikuar gjithsej 19 rekomandime, prej të cilave:

- 8 rekomandime për auditime të periudhës janar-qershor të vitit 2026;
- 11 rekomandime të bartura nga auditimet e viti 2025.

Rezultatet e monitorimit janë si vijon:

- rekomandime të zbatuara: 7, ku 2 i përkasin auditimeve të periudhës janar-qershor të vitit 2026 dhe 5 janë rekomandime të bartura nga viti 2025;
- rekomandime në proces zbatimi: 9, ku 6 i përkasin auditimeve të periudhës janar-qershor të vitit 2026 dhe 3 janë rekomandime të bartura nga viti 2025;
- rekomandime të pazbatuara: 3, janë rekomandime të bartura nga viti paraprak dhe do të jenë objekt monitorimi edhe gjatë periudhës së dytë të vitit.

7. Bashkërendimi i aktiviteteve me Komitetin e Auditimit

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ MF Nr. 01/2019, NjAB ka ofruar mbështetje administrative dhe profesionale për Komitetin e Auditimit.

Janë realizuar dy takime për periudhën raportuese, me këto aktivitete:

- përgatitja organizative e mbajtjes së takimeve;
- përgatitja e raporteve dhe dokumentacionit mbështetës për shqyrtim, sipas rendit të ditës së përcaktuar për takim;
- Hartimi i procesverbaleve të takimit, arkivimi i dokumentacionit për secilin takim të mbajtur.

8. Bashkërendimi i aktiviteteve me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Gjatë periudhës raportuese është realizuar koordinim i vazhdueshëm me Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke përfshirë:

- koordinimin gjatë auditimit të Pasqyrave Financiare të Komunës për vitin 2025(shkurt-qershor 2026);
- koordinimi dhe përkrahja profesionale për anëtare e grupit punues për përgatitjen dhe harmonizimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së;
- koordinimin për raportimin periodik mbi zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së.

9. Detyrat e Shërbimit Këshillues dhe aktivitetet tjera të NjAB-së

Përveç detyrave audituese, NjAB ka realizuar edhe:

- përgatitjen e raportit të gjashtëmujorit të dytë(periudhën korrik-dhjetor 2025) dhe Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2025 për Kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe NjQHAB/MFPT (raportuar në janar 2026);
- përgatitjen e raportit gjashtëmujor për periudhën janar-qershor 2026, për Kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe NjQHAB/MFPT (raportuar në korrik 2026);
- përgatitjen e Raportit Vjetor për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm për vitin 2025(raportuar mars 2026);
- pjesëmarrje në takimet e menaxhmentit komunal;
- ofrimin e këshillave profesionale për drejtoritë komunale lidhur me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar;
- pjesëmarrje në punëtori, trajnime dhe aktivitete profesionale të organizuara nga MFPT, IKAF, IKAP dhe institucione të tjera.

10. Sfidat e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm në Komunën e Prizrenit përballët me sfida të ngjashme me ato të organizatave tjera buxhetore. Sfida kryesore mbetet mungesa e stafit të mjaftueshëm, e cila ndikon drejtpërdrejt në mbulimin e plotë të fushave me rrezik.

Një tjetër sfidë është niveli i zbatimit të rekomandimeve. Përkundër progresit të arritur, ende vërehet vonesë ose zbatim i pjesshëm i disa rekomandimeve, që kërkon angazhim më të madh të menaxhmentit dhe drejtorive komunale. Po ashtu, ndryshimet e shpeshta ligjore përbëjnë pengesa shtesë në rritjen e efektivitetit të auditimit të brendshëm.

11. Përfundim

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar aktivitetet kryesore të parapara në Planin Vjetor të Auditimit dhe ka kontribuar në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, përmirësimin e menaxhimit financiar dhe rritjen e llogaridhënies në Komunën e Prizrenit. Rekomandimet e dhëna nga auditimet e realizuara synojnë përmirësimin e proceseve të punës, forcimin e kontroleve të brendshme, rritjen e pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe përdorimin më efikas të burimeve publike.

NjAB do të vazhdojë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2026 me realizimin e detyrave të mbetura sipas Planit Vjetor të Auditimit, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe ofrimin e mbështetjes profesionale për menaxhmentin në funksion të përmirësimit të qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm.

Korrik 2026,
Prizren

Udhëheqësi i NjAB
Agron Hoxha

